



RAPORT
MONITORIMI
- Drejtësia -

Ndihma juridike e garantuar nga shteti

Maj-Korrik
2021

AUTOR
**Megi
Ndregjoni**

QENDRESA
QYTETARE



NED

National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al



Ndihma juridike e garantuar nga shteti. Sfidat, problematikat dhe perceptimi qytetar

Një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor është mundësia faktike e qytetarëve për të marrë pjesë në procese të ndryshme. Procesi i rregullt ligjor është i garantuar nga një sërë aktesh ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut etj. Të gjithë këto instrumente parashikojnë të drejtat e individëve për mbrojtje ligjore, për barazi para ligjit, për mjete juridike efektive etj. Një nga mekanizmat thelbësorë për të garantuar pjesmarrjen në procese është ndihma juridike e garantuar nga shteti.

¹Në disa prej rekomandimeve më të rëndësishme të Komitetit të Ministrave në Këshillin e Europës, është vendosur standardi se ndihma juridike duhet të mundësohet jo vetëm për mbrojtjen ligjore në proceset gjyqësore, por edhe në rastet e nevojës për këshillim ligjor, për të gjithë qytetarët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike.

Në vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për Ndhmën Juridike të garantuar nga shteti në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Ky studim ka për qëllim të parashtojë një përmbledhje të ligjit nr.111/2017 "Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti" si dhe përfituesve të saj që prej vitit 2019.

Përmes këtij studimi synohet të analizohet ligji për ndihmën juridike në tre aspekte:

- a) Analizë e Llojeve të ndihmës juridike dhe subjekteve
- b) Analizë e Numrit të përfituesve të ndihmës juridike
- c) Perceptimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike

¹ Rekomandimi R (81)7 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Masat për Lehtësimin e Aksesit në Drejtësi, Këshilli i Evropës. <https://rm.coe.int/168050e7e4>.

Rekomandimi R (93)1 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Aksesin Efektiv në Ligj dhe në Sistemin e Drejtësisë për të Varfrit, Këshilli i Evropës.

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016804df0ee

Gjithashtu raporti synon të paraqesë një panoramë të përgjithshme përmes paraqitjes së statistikave mbi përfituesit e ligjit, numrit të ofruesve të ndihmës juridike dhe përceptimit të qytetarëve. Përmes një ankete të publikuar online ne kemi marrë të dhëna nga qytetarë të grupmoshave të ndryshme mbi efektivitetin që ka ky mekanizëm në krijimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve të cilët ndodhen në pamundësi ekonomike.

i

Ligji për ndihmën juridike: Përfituesit, Llojet dhe ofruesit e saj

²Në Shqipëri, deri në vitin 2008, ndihma juridike parashikohej vetëm në legjisllacionin penal, në kuadër të mbrojtjes së detyruar. Një ligj specifik për ndihmën juridike u miratua për herë të parë në vitin 2008.

³Ligji "Për Ndhmën Juridike" u ndryshua në vitin 2013 dhe në vitin 2014 dhe u përmirësua duke zgjeruar kategoritë përfituese nga ndihma juridike, përfshirje në ndihmën juridike dhe përjashtimin, në proceset gjyqësore civile dhe administrative, të individit nga detyrimi për pagimin e taksës mbi aktet, si dhe i shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, krijimin e klinikave ligjore vendore etj.

Pavarësisht ndryshimeve, ligji nuk i rezistoi kohës dhe pas afërsisht 10 vjetësh u miratua e një ligj i ri, pjesë e paketës së reformës në drejtësi.

⁴Ligji nr 111/2017 rregullon procedurën, kushtet dhe organet kompetente që ofrojnë ndihmën ligjore falas.

Ligji fillimisht përkufizon konceptin e ndihmës juridike duke dhënë një orientim për të gjithë praktuesit e së drejtës. Sipas tij me ndihmë juridike është shërbimi juridik falas për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat përballohen nga buxheti i shtetit.

Për të qënë përfitues duhet që personi të ⁵jetë:

-shtetas shqiptar ose me vendbanim të përhershëm të Shqipëri

-shtetas të huaj apo pa shtetësi të cilët kanë një leje qëndrimi në vend⁶ ose që përfitojnë nga një marrëveshje ndërkombëtare

-azilkërkuesit të cilët kanë statusin e refugjatit dhe ata të cilët janë në proces gjyqësor për kundërshtimin e rrefuzimit të azilit në vend.

² Raport Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi, Dr.Klesta Hysi, faqe 32
<https://ëëë.osfa.al/sites/default/files/raport-monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejttesi.pdf>

³ Po aty.

⁴ Më poshtë Ligji për Ndhmën Juridike

⁵ Neni 10 i Ligjit

⁶ Për më shumë shih Ligjin "Për të huajt"

Sa më sipër janë kushte të përgjithshme ku mund të zbatohet ligji shqiptar për ndihmën juridike, ndërkohë ky i fundit përcakton disa kushte si më poshtë për të përfituar nga ky ligj:

a) viktimave të dhunës në familjes, të abuzuar seksualisht dhe të trafikimit të qenieve njerëzore,

c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin

ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore dhe nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor

dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm dhe vullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar

g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Përveç sa më sipër nga ndihma juridike mund të përfitojnë dhe personat, të ardhurat e të cilëve nuk shkojnë më shumë se 50 përqind e pagës minimale mujore. Kjo në rastin se personi ka një familje.

Në rast të kundërt duhet që të ardhurat e personit të jenë më pak se paga minimale sipas legjislacionit në fuqi.

Legjislacioni shqiptar parashikon tre lloj ndihmesh juridike:

A) Ndihma ligjore parësore

Qytetarët mund të përfitojnë këtë lloj ndihme përmes punonjësve të specializuar që ndodhen pranë qendrave për shërbim ligjor falas, nga Organizata Joqeveritare të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe klinikat ligjore pranë Fakulteteve të Drejtësisë.

Ndihma juridike parësore⁷përfshin:

1. Këshillim mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
2. Këshillim mbi për procedurat e ndërmjetësimit dhe mënyrat e tjera alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve⁸

⁷ Neni 3 pika ç

⁸ Në vendin tonë ndërmjetësimi është e vetmja metodë alternative e zgjidhjes së konfliktit e rregulluar ligjërisht. Gjithashtu ndërmjetësimi parashikohet në Kodin e procedurës Civile, Penale dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Kuvendi pritet të miratojë një ligj të posaçëm mbi arbitrazhin kombëtar, projektligj I cili do të rregullojë këtë metodë alternative.

3. Këshillimin dhe hartimit të dokumentacionit për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për kërkimin e ndihmës juridike detyësore si dhe përfaqësim para organeve të administratës.

Cilat janë subjektet që e ofrojnë këtë ndihmë juridike?

- Punonjës të trajnuar posaçërisht në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Aktualisht Drejtoria për Ndhmën Juridike administron qendra të ndihmës juridike parësore në Tiranë, Elbasan, Lezhë, Durrës, Lushnje, Fier, Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër dhe Dibër.

- OJQ-të

Në vend aktualisht janë 12 organizata joqeveritare të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas. (Këtu mund të vendosim tabelën me emrat dhe selitë e tyre)

- Klinikat ligjore

Klinikat juridike janë organizma të krijuara në institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore. Ata mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Ndhmës Juridike dhe mund të ofrojnë një nga shërbimet e mësipërme. Në vend ekzistojnë këto klinika ligjore:

Në institucionet e arsimit të lartë ekzistojnë klinikat ligjore të mëposhtme:

1. Universiteti Luarasi
2. Universiteti Europian i Tiranës
3. Universiteti Ësdom
4. Universiteti Alexander Moisiu, Durres
5. Universiteti Ismail Qemali, Vlora
6. Universiteti "Beder"
7. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë
8. Universiteti "Qirjazi"
9. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
10. Klinika e Ligjit Shkodër

Procedura për përfitimin e ndihmës parësore

⁹Me anë të një kërkesë me shkrim ose me gojë drejtuar njërit prej tre subjekteve çdo qytetar mund të përfitojë ndihmë juridike falas, kur përmbushen kushtet e listuara më sipër. Ai nënshkruan vetëdeklarimin e hartuar nga Ministria e Drejtësisë ku pranon se përmbush kriteret ligjore për të marrë këtë shërbim.

Të gjithë subjektet ofrojnë në mënyrë të menjëhershme dhe vetëm një herë për të njëjtën problematikë ndihmën parësore, përveç kur rezultojnë rrethana të reja që e justifikojnë dhënien e ndihmës ligjore për të njëjtën çështje.

Në legjislacione të ndryshme perëndimore njihet dhe pajtimi si metodë alternative. Kjo metodë në vend është e parashikuar si detyrë e gjykatës për të arritur zgjidhje për mosmarrëveshje. (neni 25 i Kodit të Procedurës Civile, neni 228 I Kodit të Procedurës Penale)

⁹ Neni 17

Analizë e përfituesve të ndihmës juridike parësore

Sipas të dhënave të marra nga Ministria e Drejtësisë, prej vitit 2019 e deri në prill të vitit 2021 692 qytetarë kanë përfituar ndihmë parësore.

Viti	Numri i përfituesve
2019	23 përfitues
2020	4191 përfitues
2021	2707 përfitues

Ajo që vihet re është se gjatë vitit 2020 ka një numër të lartë të personave të cilët kanë përfituar këtë ndihmë. Viti 2020 ka qënë një vit i vështirë ku sipas të dhënave të ¹⁰Instat ka patur një ulje të numrit të punësuarve me 3.6 përqind me një vit më parë, 2019. Kjo do të thotë që një numër kaq i lartë i kërkesave ka ardhur si pasojë ndikimit të pandemisë në ekonominë e qytetarëve. Pandemia rriti ndjeshëm numrin e të papunëve për periudhën Mars-Dhjetor 2020, ndërkohë që hapja e vendeve të lira të punës ishte në nivel shumë të ulët. Mundësia që ata gjatë vitit 2020 të paguajnë për këshillim ligjor ka qënë e pakët, gjë që ka sjellë një rritje të përfituesve të ndihmës parësore.

Më poshtë po sjellim një tabelë përmbledhese me rastet e trajtuara nga ofruesit e ndihmës juridike parësore.

Ofruesit e ndihmës parësore	2020	2021
OJQ-të	960	849
Punonjësit e specializuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore	1426	850
Klinikat Ligjore	41	25

¹⁰ <https://www.monitor.al/pandemia-goditje-te-lehte-ne-tregun-e-punes-papunesia-u-rrit-me-04-ne-tremujorin-e-dyte-te-vitit/>

Nga tabela e mësipërme mund të shihet qartë se numri më të lartë të rasteve e kanë trajtuar punonjësit e specializuar. Në vend ne kemi 9 qendra të cilat ¹¹ofrojnë këtë shërbim. Ato kryesisht janë të vendosura pranë insitucioneve shtetëore si prokuroritë apo gjykatat dhe kjo i bën ato më të aksesueshme. Konkretisht:



- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Tiranë
Adresa: Ministria e Drejtësisë, Bulevardi “Zogu 1”, Tiranë
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Durrës
Adresa: lagjja Nr 2, Rruga “Aleksandër Goga”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Lushnje
Adresa: Lagjja “Kongresi i Lushnjes”, Rr. “Bajram Haxhiu” pranë Bashkisë Lushnje
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Pogradec
Adresa: Bulevardi Rreshit Çollaku, Lagja 2, pranë Bibliotekës Mitrush Kuteli, Pogradec
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Gjirokastrë
Bulevardi “18 Shtatori” në ambientet e ADISA, Gjirokastrë
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Lezhë
Adresa: lagjja “Skanderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti” pranë bashkisë Lezhë
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Shkodër:
Adresa: Rruga “Don Bosko”, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Fier:
Adresa: Rr. Ramiz Aranitasi, pranë ADISA, Fier
- **Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**, Dibër:
Adresa: Rr. Avdyl Frashëri, Qendër Tomin, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër

¹¹ Për më shumë informacion klikoni në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike:
<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/ndihma-juridike-paresore/>



Organizatat jofitimprurëse renditen të dyta për ofrimin e shërbimit. Kjo lidhet me dy arsye kryesore: Së pari OJF-të kanë marrë autorizim nga Ministria në shtator 2020. Së dyti për shkak të pandemisë ka qënë e vështirë kontakti me këto organizata.

Në vend kemi aktualisht 12 të tilla. OJF-të mbështeten për këtë aktivitet nga Ministria e Drejtësisë, e cila alokon një fond për to në mënyrë që të realizojnë këtë shërbim ndaj qytetarëve.

OJF-të në veprimtarinë e tyre organizojnë aktivitete informuese në lidhje me ndihmën falas, gjë e cila i mundëson takime me qytetarë. Megjithatë 8 nga 12 OJF-të e kanë selinë në Tiranë, ndërkohë kemi 1 në Berat, 1 në Elbasan, 1 në Shkodër dhe 1 në Durrës.

Ndryshe ndodh me klinikat ligjore në universitetet. Ato kanë një numër të ulët të rasteve pasi ato ndodhen në ambientet e universiteteve të drejtësisë dhe nuk kanë aktivitete të shumta informuese.

Si përfundim, ajo që mund të themi është që duhet të kemi forcim të klinikave ligjore në univeristete si dhe rritje të bashkëpunimit mes këtyre të fundit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu Ministria e Drejtësisë duhet të autorizojë më shumë OJF jashtë qyteteve kryesore të vendit.

B) Ndihmë juridike dytësore

¹²Ndihmë juridike dytësore është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

Që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, **439 qytetarë kanë përfituar ndihmë dytësore**¹³.

Viti	2019	2020	2021
Numri i përfituesve	44	181	214

¹² Neni 18 I ligjit

¹³ Këtu përfshihen dhe të dhënat e personave të cilët kanë përfituar nga përjashtimi I tarifave gjyqësore

Ne dallim nga ndihma juridike parësore, viti 2020 ka një numër më të ulët të rasteve për ndihmë juridike dytësore. Kjo lidhet direkt me punën e gjykatave. Gjatë periudhës mars-prill Këshilli i Lartë gjyqësor vendosi¹⁴ pezullimin e punës së gjykatave. Gjithashtu numri i lartë i infektimeve të gjyqtarëve kanë ndikuar në procese të tilla.



Cilët subjekte e ofrojnë këtë lloj ndihme juridike?

Kjo lloj ndihme ofrohet vetëm nga avokatët e rregjistruar në Dhomën e Avokatisë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë numri i avokatëve ka ardhur në rritje.

Sipas të dhënave kemi: Gjatë 2019: 70 avokatë

Gjatë 2020: 73 avokatë

Gjatë 2021: 124 avokatë

Ne vitin 2020 Ministria e Drejtësisë miratoi shpërblimet për avokatët në bazë të shërbimeve të tyre.¹⁵ Ato variojnë **nga 15 mijë lekë deri në 96 mijë lekë**. Në rast të një çështjeje civile Drejtoria e ndihmës juridike jep një shpërblim 15 mijë lekë për përfaqësim në shkallë të parë si dhe 500 lekë/ora për këshillim ligjor në lidhje me çështjen. Gjithashtu avokatit i mbulohen të gjitha shpenzimet që i nevojiten për të dhënë shërbimin e kërkuar.

Procedura për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Kërkesa për ndihmë dytësore i drejtohet gjykatës ose prokurorisë, në kohën e fillimi të hetimeve nga vetë personi ose personi i autorizuar prej tij.

Kërkesa mund të depozitohet personalisht ose nëpërmjet postës si dhe përmes një përfaqësuesi ligjor, një përfaqësuesi me procure, nga bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/sja ose një person me të cilin/cilën ka lidhje farefisnie deri në shkallën e parë.¹⁶

Prokuroria dhe gjykata vlerësojnë nëse personi i plotëson kushtet për të marrë ndihmë dytësore ligjore.

Nëse prokuroria vlerëson se i pandehuri ndodhet në kushtet ligjore për të marrë ndihmë juridike dytësore i cakton një avokat nga lista e atyre që

¹⁴ <http://klgj.al/ep-content/uploads/2020/04/VENDIM-Nr.133-date-6.04.2020-vendim-Per-pezullim-veprimtarie-ne-gjykata-.pdf>

¹⁵ <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2020/09/Udh%C3%ABzim-i-p%C3%ABrbashk%C3%ABt-i-ministrit-t%C3%AB-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-dhe-i-ministrit-t%C3%AB-Financave-dhe-Ekonomis%C3%AB-nr.-18-dat%C3%AB-5.8.pdf>

¹⁶ Neni 19 pika 2 i ligjit

ofrojnë ndihmë ligjore. Nëse i refuzohet kërkesa personi ka të drejtën e ankimit në gjykatën penale që po shqyrton çështjen.

Kur kërkesa i drejtohet gjykatës, kjo e fundit vlerëson nëse personi plotëson ose jo në kushtet e ligjore .

¹⁷Brenda afateve ligjore, gjykata vendos ti japë ose jo ndihmën ligjore. Personit i lind e drejta në rast refuzimi të apelojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Analizë e përfituesve të ndihmës juridike dytësore

	Viti	2019	2020	2021
Numri i kërkesave të pranuar		21	102	96
Numri i kërkesave të rrëzuara		3	20	6

Nga sa më sipër mund të konkludohet se kryesisht kërkesat për ndihmë dytësore pranohen nga gjykata.

C) Përjashtimi nga tarifat gjyqësore, shpenzimet gjyqësore dhe ato të përmbarimit.

Me marrjen e ndihmës juridike personi i lind e drejta të përjashtohet nga tarifat gjyqësore që janë të parashikuara me ligj të veçantë¹⁸. Gjithashtu ata përjashtohen nga:

- pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Procedura për përfitimin e saj

Çdo qytetar që përfiton ndihmë dytësore mund t'i bëjë kërkesë gjykatës që po shqyrton çështjen për tu përjashtuar nga tarifat gjyqësore, shpenzimet gjyqësore dhe ato përmbarimore.

Gjykata mund të pranojë ose të refuzojë kërkesën e personit. Personi në rast refuzimi mund të apelojë vendimin në gjykatën e apelit.

¹⁷ Neni 21 dhe 22 i ligjit

¹⁸ Për më shumë shih Ligjin nr. 98/2017 PËR TARI FAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

	Viti	2019	2020	2021
Numri i kërkesave të pranuar		25	45	25
Numri i kërkesave të rëzuara		1	1	1

Edhe sa më sipër mund të konkludojmë se përgjithësisht gjykatat pranojnë kërkesat për përjashtim nga tarifat gjyqësore.

Në vitin 2020 Ministria e Drejtësisë së bashku me Fondacionin Shoqëri e Hapur krijoi një platforme online të dedikuar shërbimeve ligjore falas ([juristi online](#)) si dhe vendosjen në dispozicion të numrit të gjelbër falas 08001010.

Sipas të dhënave nga Ministria e Drejtësisë, që prej marsit të vitit 2020 e deri në prill 2021, 3262 qytetarë kanë përfituar këshillim ligjor.

Viti 2020	Numri i përfituesve përmes platformës juristionline
Mars-Korrik	765 persona
Gusht	146 persona
Shtator	167 persona
Tetor	153 persona
Nëntor	135 persona
Dhjetor	158 persona
Totali	1524 persona

Viti 2021	Numri i përfituesve përmes platformës juristionline
Janar	168 persona
Shkurt	203 persona
Mars	209 persona
Prill	128 persona
Totali	708 persona

Viti 2020	Numri i përfituesve përmes numrit të gjelbër
Maj-Korrik	131 persona
Gusht	0 persona
Shtator	0 persona
Tetor	12 persona
Nëntor	45 persona
Dhjetor	52 persona
Totali	240 persona

Viti 2021	Numri i përfituesve përmes numrit të gjelbër
Janar	76 persona
Shkurt	61 persona
Mars	81 persona
Prill	57 persona
Totali	275 persona

Perceptimi i qytetarëve në lidhje me ndihmën juridike falas

Për të marrë informacion në lidhje me ndihmën juridike, Qendresa Qytetare ka hartuar një pyetësor. Pyetësi përbëhej nga 11 pyetje dhe kishte në qendër perceptimin e qytetarëve për ndihmën juridike falas.

Nga përgjigjet e marra, Tirana mban vendin e parë për kërkesat për ndihmë juridike me 34.1 përqind, ndërsa vendin e dytë e mban Shkodra me 7.1 përqind dhe në vend të tretë janë Durrësi dhe Elbasani me 4.7 përqind.


Rreth 59.3% e të anketuarve nuk kanë informacion për ndihmën juridike. Ndërsa 40.7% e të anketuarve kanë pohuar se kanë informacion për ndihmën juridike.



A keni informacion mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti?


Në një përgjigje për Qendresën, Drejtoria për Ndihmën Juridike se gjatë dy viteve **2020 dhe 2021 ka zhvilluar 45 aktivitete ndërgjegjuese e informuese.**

Pyetjes se si ata kanë marrë informacion, 40.4 përqind kanë pohuar "Përmes Medias", 31.9 përqind përmes OJF-ve dhe 23.4 përqind përmes institucioneve shtetërore. Ndërsa vetëm 4.3% kanë marrë informacion përmes gjykatës ose prokurorisë.



Vetëm 26.1% e të anketuarve kanë përfituar ndihmë juridike, ku:

- 56.1% e tyre kanë marrë këshillim ligjor
- 26.5% e tyre përfaqësim në gjykatë
- 14.6% e tyre përfaqësim në institucionet shtetërore
- 2,5% e tyre hartim të akteve



Gjetjet kryesore



Gjatë vitit 2020 kemi patur një rritje të numrit të personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike parësore dhe një ulje të atyre të cilët kanë pëfituar ndihmë juridike dytësore, për shkak të vështirësive të pandemisë dhe bllokimit të gjykatave.



Vendin e parë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore e mbajnë qëndrat e shërbimeve për ndihmën juridike, në vend të dytë renditen OJF-të dhe në fund klinikat ligjore.



Pavarësisht se Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar 45 aktivitete informuese përgjatë 2 viteve, 60% e qytetarëve të anketuar shprehen se nuk kanë informacion për ndihmën juridike falas.

Rekomandimet kryesore



Ministria e Drejtësisë duhet të autorizojë më shumë OJF jashtë qyteteve kryesore të vendit për të ofruar ndihmë juridike falas.



Duhet të forcohen klinikat ligjore pranë universiteteve dhe të rritet bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë.



Qytetarët duhet të informohen mbi llojet e ndihmës juridike dhe kjo kërkon një shtim të aktiviteteve informuese nga Drejtoria e Ndihmës Juridike.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI
Drejtësia
Maj-Korrik 2021